



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

## RAPORTI I KOMISIONIT PROFESIONAL-SHKENCOR PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS SË ZGJEDHJES SË BASHKËPUNËTORIT SHKENCOR PËR STUDIME NDËRDISIPLINARE DHE SHKENCË KOGNITIVE NË INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë kërkimore-shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2003), neni 48 të të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 55/24 të datës 12.09.2024 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të punës numër 03/L212, vendimit nr. 111/24 të datës 26.12.2024, Këshilli Shkencor i Institutit ka shpallur konkurs për zgjedhje të punonjësve shkencorë dhe të hulumtuesve, për një pozitë: **Bashkëpunëtor shkencor për studime ndërdisiplinare dhe shkencë kognitive** në Institutin Pedagogjik të Kosovës, që ishte pjesë e shqyrtimit nga ky komision.

Komisioni, pasi e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkurs, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor për kandidatet e paraqitura për pozitën Bashkëpunëtor shkencor për studime ndërdisiplinare dhe shkencë kognitive.

## VLERËSIMI PROFESIONAL DHE SHKENCOR

Komisioni, pasi e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkurs, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor.

Detyra e komisionit është të shqyrtojë dokumentacionin dhe të hartojë raportin profesional. Me hartimin e raportit përfundon puna dhe përgjegjësia e këtij komisioni. Komisioni për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së Bashkëpunëtorit shkencor, i emëruar në mbledhjen e Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës, ka këtë përbërje: Prof.dr. Tringa Dedi (Kryetare), Prof.Asoc.dr. Sejdi Sejdiu (Anëtar), Prof.Ass.dr. Edona Berisha Kida (Anëtare).

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, Statutit të Institutit Pedagogjik, si dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, procedura vlerësuese për zgjedhje/rizgjedhje mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet si në vijim:

- Të ketë shkallën e doktorit të shkencave;
- Të ketë të botuar së paku një (1) punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare. Punimet duhet të jenë të njohura sipas rregulloreve në fuqi;
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit, nga fusha përkatëse; - Të ketë përvojë të dëshmuar për aktivitetet shkencore e profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs;
- Të ketë të botuar monografi shkencore nga fusha përkatëse;
- Përparësi do të kenë kandidatët me njohje të dëshmuar të Gjuhës angleze.

### **Sipas konkursit në fjalë kandidati i zgjedhur pritet të kryej këto detyra:**

- Harton projekte kërkimore- shkencore nga fusha përkatëse;
- Planifikon dhe realizon studime ndërdisiplinore që ndërlidhin neuroshkencën kognitive, gjuhësinë dhe edukimin, duke kontribuar në avancimin e praktikave pedagogjike;
- Analizon ndikimin e dygjuhësisë dhe gjuhësisë në zhvillimin kognitiv dhe përpunimin e informacionit në kontekste edukative;
- Propozon dhe përgatitë metoda mësimore të personalizuara dhe programe edukative bazuar në rezultatet më të fundit të neuroshkencës dhe metodave ndërdisiplinore;
- Aplikon instrumente si eye-tracking, elektroencefalografi (EEG) dhe detyra kognitive për të studiuar procese mendore komplekse dhe për të përmirësuar mësimdhënien;

- Mbledh dhe analizon të dhëna për të vlerësuar efektivitetin e metodave mësimore dhe për të sugjeruar përmirësime të bazuara në evidencë;
- Përgatit dhe publikon artikuj shkencorë në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe prezanton rezultatet e kërkimeve në konferenca shkencore;
- Ofron trajnime dhe punëtori për edukatorë, mësues dhe kërkues shkencorë, duke i udhëzuar në përdorimin e metodave dhe teknologjive të avancuara;
- Mbështet hulumtuesit e rinj dhe studentët në realizimin e projekteve shkencore dhe ndihmon në ngritjen e kapaciteteve kërkimore;
- Merr pjesë aktive në projekte të përbashkëta kërkimore me punonjës shkencor dhe hulumtues për të zhvilluar qasje inovative realizuar studime krahasuese në edukim dhe shkencë;
- Harton plane vjetore për aktivitetet kërkimore dhe edukative dhe siguron realizimin e tyre sipas objektivave të Institutit;
- Shkruan recensione dhe vlerësim sipas kërkesës së Institucionit;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

Duke u mbështetur në dokumentacionin dhe dosjen e dorëzuar nga kandidatet, komisioni vërteton se në konkursin e shpallur më datë 15.01.2025, në gazetën "Epoka e re" dhe në faqen zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për pozitën e Bashkëpunëtorit shkencor për studime ndërdisiplinare dhe shkencë kognitive, kanë konkurruar dy kandidatë- znj. Amantina Pervizaj Kelmendi me numër protokolli 03/25 datë konkurrimi 28.01.2025 dhe znj. Saranda Buzhala me numër protokolli 04/25, datë konkurrimi 30.01.2025.

Komisioni, pasi e verifikoi dokumentacionin e dorëzuar, ka konstatuar se të dy kandidatet i plotësojnë kushtet formale juridike për t'ju nënshtruar procedurave të përzgjedhjes për Bashkëpunëtor shkencor. Komisioni i ka shqyrtuar dosjet e kandidatëve dhe në bazë të kriterëve të shpallura në konkurs, thirrjen shkencore, përvojën e punës, të arriturat profesionale shkencore, projektet për zhvillimin e punës profesionale-shkencore, i ka paraqitur të dhënat biografike dhe bibliografike si më poshtë:

**Tabela 1**

Shënimet përmbledhëse për kandidatët e paraqitur për pozitën: Bashkëpunëtor shkencor për studime ndërdisiplinare dhe shkencë kognitive në Institutin Pedagogjik të Kosovës

Nr.	Emri dhe mbiemri	Titulli Dr.sc.	Punim shkencor (indkuar në SCOPUS)	Aktivitete shkencore	Monografi/Botime të veçanta	Njohja e gjuhës angleze	Propozimi
1	Amantina Pervizaj	“Doktoreshë e Shkencave (dr.sc) nga fusha Shkencore e Shkencave Ndërdisiplinore, fusha Shkencore e Shkencës Kognitive”. Universiteti i Zagrebit	<p><b>1. The Role of pre-school Teachers (educators) in Developing Verbal Communication of Bilingual pre-school Children</b></p> <p>The International Journal for Education / Rehabilitation and Psychosocial Research ISSN 2232- 9935 (print)/ ISSN 2232-996X (online)</p> <p>Vëllimi 15, Issue 1, 2025. Revistë e indeksuar në Scopus</p> <p><b>2. Optimizing Language Proficiency: A Focus on Second Language Learning Strategies.</b></p> <p>Pakistan Journal of Life and Social Sciences E-ISSN: 2221-7630;P-ISSN: 1727-4915</p>	<p>3 Konferenca ndërkombëtare/ rajonale</p> <p>5 Konferenca vendore</p>	<p>Një Monografi</p> <p>1. Eye-tracking based investigation on L2 Albanian Learners of English professional/content vocabulary knowledge processing</p> <p>Zagreb, 2023</p>	Studimet bachelor në Gjuhë angleze C2 sipas CEFR	Pranohet

			<p>Vellimi 22 -2  Faqet: 13226-13251  Viti 2024  <a href="https://pjlss.edu.pk/pdf_files/2024_2/13226-13251.pdf">https://pjlss.edu.pk/pdf_files/2024_2/13226-13251.pdf</a></p> <p>Revistë e indeksuar në Scopus</p>				
2	Saranda Buzhala	Dr.sc. Doktor i shkencave filologjike, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	<p><b>1. <u>The beautiful woman as the ideal of the knight in Albanian heroic songs</u></b></p> <p><i>Edelweiss Applied Science and Technology</i></p> <p>Vol. 8(6), pages 7775-7781</p> <p><a href="https://www.edelweissappliedscience.com/learning-gate/ideas/repec">Edelweiss Applied Science and Technology, Learning Gate   IDEAS/RePEc</a></p> <p>Revistë e indeksuar në Scopus</p> <p><b>2. Contemporary Teaching in Albanian Language and Literature</b></p> <p><i>Pakistan Journal of Life and Social Sciences</i> (2024), 22(2):13196-13205</p> <p>Revistë e indeksuar në Scopus</p>	<p>8 Konferenca ndërkombëtare/ rajonale</p> <p>11 Konferenca vendore</p>	<p>Dy Monografi në fushën e letërsisë</p> <p>1. Miti si strukturë semantike dhe strategji retorike në letërsinë shqipe mes dy luftërave botërore</p> <p><a href="https://filologjia.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,91,2024">https://filologjia.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,91,2024</a></p> <p>2. Miti i Prometeut eskilian sipas Kadaresë: aspekte krahasimtare nga letërsia greke dhe letërsia shqipe</p> <p>Universiteti “Fehmi Agani”, Gjakovë, 2024</p>	Nuk ka dëshmi	Refuzohet

		<p><b>3. Professional Development Needs of Primary and Lower Secondary Teachers</b></p> <p><i>Pakistan Journal of Life and Social Sciences</i></p> <p>22(1): 5954-5968</p> <p>Revistë e indeksuar në Scopus</p> <p><b>4. The Study on Comparative and Intertextual Levels, as a Theoretical and Analytical Approach between the Two Novels "Leximtari", Bernard Shlink and "Lëvdatë për Njerkën", Mario Vargas Llosa</b></p> <p><u><a href="#">Vol. 13 No. 1 (2023): January 2023</a></u></p> <p><i>Journal of Educational and Social Research</i></p> <p>Revistë e indeksuar në Scopus</p> <p><b>5. Transfigurations of the Myth of Narcissus - Intertextuality, Re-</b></p>				
--	--	---	--	--	--	--

			<p><b>Contextualization and Symbolism of Reflection: Oscar Wilde's "The Picture of Dorian Gray" and Ernest Koliqi's "Pasqyrat e Narcizit" ("The Mirrors of Narcissus")</b></p> <p><i>Journal of Educational and Social Research</i></p> <p><a href="#">Vol. 13 No. 4 (2023): July 2023</a></p> <p>Revistë e indeksuar në Scopus</p>				
--	--	--	---	--	--	--	--

## PËRFUNDIM

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013, si dhe Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, nr.01/B, nr.1740, të datës 11.06.2024, Rregullores nr. 55/24 për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës të datës 12.9.2024, në bazë të kriterëve dhe detyrave të përcaktuara me konkursin e shpallur me datë 15.01.2025, si dhe bazuar në të arriturat profesionale dhe shkencore, komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së Bashkëpunëtorit shkencor për studime ndërdisiplinare dhe shkencë kognitive në Institutin Pedagogjik të Kosovës, i propozon Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës kandidaten **Amantina Pervizaj Kelmendi**, e cila i plotëson të gjitha kushtet e parapara në konkurs.

## ARSYETIM

Kandidatja Dr. Sc. Amantina Pervizaj Kelmendi ka të përfunduara studimet e doktoratës “Doktoreshë e Shkencave (dr.sc) nga fusha Shkencore e Shkencave Ndërdisciplinore, fusha Shkencore e Shkencës Kognitive” dhe kështu ka plotësuar kërkesën e parë të konkursit gjegjësisht pozitën e kërkuar Bashkëpunëtor shkencor për studime ndërdisiplinare dhe shkencë kognitive.

Kandidatja Dr. Sc. Amantina Pervizaj Kelmendi ka publikuar një monografi në fushën e kërkuar, i ka të publikuara dy punime shkencore të indeksuara në platformën SCOPUS të cilat mund të verifikohen në këtë databazë si dhe ka marr pjesë në disa aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Gjithashtu ka dëshmi për njohjen e gjuhës angleze, si përparësi e kërkuar me konkurs.

Në raport me kandidaten tjetër, më së miri i plotëson të gjitha kushtet e konkursit prandaj komisioni e propozon kandidaten **Amantina Pervizaj** për pozitën e Bashkëpunëtores shkencore për studime ndërdisiplinare dhe shkencë kognitive.

*Prishtinë, më 05.02.2025*

### **Komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së Bashkëpunëtorit shkencor në IPK**

1. Prof.dr. Tringa Dedi (Kryetare) \_\_\_\_\_
2. Prof.Asoc.dr. Sejdi Sejdiu (Anëtar) \_\_\_\_\_
3. Prof.Ass.dr. Edona Berisha Kida (Anëtare) \_\_\_\_\_